

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА
FACULTY OF LANGUAGES, CULTURES AND COMMUNICATION

KATEDRA E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

**PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE STANDARDE NË SHKOLLËN FILLORE DHE
TË MESME NË ISTOG**

Mentori:
Prof. dr. Zeqir Kadriu

Studenti:
Nexhiba Ramadani

TETOVË, 2020

Abstrakti

“Të mos këtë më mësues që nuk dinë të flasin gjuhën letrare”

Xhevat Lloshi

Në vitin 1972, në Tiranë, është mbajtur Kongresi I Drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Siç e dimë, po aty është marr vendimi për standardizimin ose njësimin e gjuhës shqipe letrare, e cila do të duhej të zbatohet nga të gjithë shqipfolësit që banojnë në trevat shqiptare. Shumë përpjekje për t’a standardizuar gjuhën tonë ka patur edhe para vitit 1972. Sot, edhe pse shumë vite pasi që studiuesit tanë të mëdhenj e kanë “sistemuar” gjuhën standarde sipas rregullave gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, kemi një problem shumë të madh me të cilin jo rrallëherë ballafaqohemi – mospërdorimi ose më mire e thënë mosnjohja e gjuhës standarde nga ana e mësimit, të cilët janë “kyçi” i arsimit. Këtë problematikë e shohim nëpër shkollat të ndryshme ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Kemi vendosur që të bëjmë një hulumtim në njërin prej qyteteve të Kosovës, Istogut. Në këtë punim do t’i shohim rezultatet nga hulumtimi, do shohim sa nga mësimit e anketuar e përdorin gjuhën standarde, sa prej tyre preferojnë të komunikojnë me nxënësit në të folmen e vendit, sa nxënësit i kuptojnë mësimit kur ligjerojnë duke përdorur gjuhën standarde, dhe si ta përmirësojmë këtë gabim.

Fjalët kyçe : gjuha standarde shqipe, përdorimi i gjuhës standarde shqipe, qyteti i Istogut, shkolla fillore, shkolla e mesme, mësimit, pyetësor.

Апстракт

„Да нема повеќе наставници кои не зборуваат литературен јазик“

Џеват Лоши

Во 1972 година, во Тирана се одржа Конгресот за Правопис на албанскиот јазик. Како што знаеме, таму се одлучи да се стандардизира или унифицира албанскиот литературен јазик, којшто треба да го применуваат сите кои зборуваат албански, кои живеат на албанските територии. Многу обиди да се стандардизира нашиот јазик имало уште пред 1972 година. Денес, и после многу години откако нашите големи научници го „систематизираа“ стандардниот јазик според граматички, лексички и правописни правила, имаме многу голем проблем со кој неретко се среќаваме - некористење или поточно непознавање на стандардниот јазик од страна на наставниците, кои се „клуч“ на образованието. Овој проблем го гледаме во различни училишта каде наставата се одвива на албански јазик. Одлучивме да направиме анкета во еден од градовите во Косово, Истог. Во овој труд ќе ги разгледаме резултатите од истражувањето, ќе видиме колку од анкетираниите наставници го користат стандардниот јазик, колку од нив претпочитаат да комуницираат со учениците со јазикот кој се употребува во местото, колку учениците ги разбираат наставниците кога предаваат со употреба на стандарден јазик, и како да ја поправиме оваа грешка.

Клучни зборови: стандарден албански јазик, употреба на стандарден албански јазик, град Истог, основно училиште, гимназија, наставници, прашалник .

Abstract

"No more teachers who don't speak literary language"

Xhevat Lloshi

In 1972, the Albanian Spelling Congress was held in Tirana. As we know, there has been a decision to standardize or unify the Albanian literary language, which should be applied by all Albanian-speaking Albanians living in Albanian lands. There have been many attempts to standardize our language before 1972. Today, although many years after our great language specialists have "systemated" the standard language according to grammatical, lexical and spelling rules, we have a major problem with which we are not infrequently faced with - the non-use or rather the ignorance of standard language by teachers, who are the "key" in education. We see this problem in different schools where the teaching is in Albanian language. We decided to do a survey in one of the cities of Kosovo, Istog. In this master thesis work we will look at the results of the research, we will see how many of the surveyed teachers use standard language, how many of them prefer to communicate with students in the native language, how much students understand teachers when teaching using standard language, and how to correct this mistake.

Keywords: standard Albanian language, use of standard Albanian language, , Istog city , elementary school, high school, teachers , questionnaire .

Mirënjohje

Do të kisha dashur që në rradhë të parë të shpreh mirënjohjet e mia për të gjithë profesorët dhe stafin akademik të Universitetit të Evropës Juglindore për gjithë diturinë që pa kursim e kanë përcjell tek ne studentet me aq përkushtim dhe mirësi, për qetësinë e tyre që gjithmonë ka mbizotëruar në çdo moment të komunikimit me neve, gjë që ka krijuar një ambient mësimi të këndshëm dhe gjithashtu na kanë dhënë shembullin se si duhet të jemi ne si mësimdhënës të së ardhmes. Kjo mirënjohje vlen veçantërisht për të respektuarin profesor Zeqir Kadriu, I cili me punën e tij të palodhshme na ka bërë që ta duam dhe ta vlerësojmë librin edhe më shumë, me këshillat e tij ka kontribuar që me vullnet të vijmë deri këtu ku jemi, në përfundim të këtij rrugëtimi të dijës - deri në magjistrim. I falënderoj të gjithë familjarët e mi për mbështetjen që ma kanë dhënë, pa ata nuk do të isha sot kjo që jam. Jam mirënjohëse ndaj bashkëshortit tim që çdo herë ka qenë aty për mua në momentët e vështirësive ,ankthit dhe pasigurisë gjatë përpilimit të tezes, që të më mbështesë dhe të më inkurajojë të vazhdoj përpara. Dhe personi I fundit dhe më I rëndësishmi që dua të falënderoj, dhe të cilit ia kushtoj këtë tezë është vajza ime *Nelina*, e cila është burim I pashtershëm energjie për mua. Ju falënderoj të gjithëve që ndatë kohën tuaj që sot të jeni prezent në mbrojtjen e tezës së magjistraturës.

Deklaratë

Unë, Nexhiba Ramadani, studente e Universitetit të Evropës Juglindore, në degën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe – studime të ciklit të dytë, nëpërmjet kësaj deklarate vërtetoj se jam autore e këtij punimi dhe e mbroj origjinalitetin e tij. Ky punim, me titull “Përdorimi I gjuhës standarde shqipe në shkollën fillore dhe të mesme në Istog”, është i hartuar në bazë të njohurive të mia dhe deklaroj se çdo pjesë e marrë nga autorë të tjerë është cituar siç duhet. Pjesa më e rëndësishme e punimit u realizua përveç me literaturën e shfrytëzuar, edhe me anë të përgjigjeve nga pyetësorët dhe anketimet, përgjigjet e të cilëve I kam marr personalisht nga mësimdhënësit e anketuar dhe të cilët I kam përpunuar dhe rezultatet e tyre I kam paraqitur me saktësi.

Data

Nënshkrimi

PASQYRA E LËNDËS

Abstrakti	1
Апстракт.....	2
Abstract.....	3
Mirënjohje.....	4
Deklaratë.....	5
I. Kapitulli i parë	
1.Hyrja.....	8
2..Lënda e hulumtimit.....	11
3.Qëllimet e hulumtimit	11
4.Hipotezat	12
5.Metodologjia e hulumtimit.....	13
6.Rëndësia e punimit	13
7. Qyteti I Istogut.....	14
8.Arsimimi dhe institucionet arsimore të qytetit.....	19

II. Kapitulli i dytë

1.Shkolla fillore “Bajram Curri”	21
2. Përdorimi I gjuhës shqipe standarde në shkollën “Bajram Curri”	25
3. Paraqitja statistikore e rezultateve nga pyetësi i bërë në shkollën “Bajram Curri”	27
4. Shkolla e mesme “ Haxhi Zeka”	33
5. Përdorimi I gjuhës shqipe standarde në gjimnazin “Haxhi Zeka”	36
6. Paraqitja statistikore e rezultateve nga pyetësi i bërë në gjimnazin “Haxhi Zeka”	38

III. Kapitulli i tretë

1. Vështrim krahasues të rezultateve nga dy shkollat	45
2. Rekomandimet nga mësimdhënësit e shkollave të Istogut në lidhje me mospërdorimin e gjuhës standarde shqipe.....	47
3. Gabimet drejtshkrimore të mësimdhënësve	50

IV. Kapitulli I katërt

1.Përfundimi.....	56
2.Bibliografia	58

I. Kapitulli i parë

1.Hyrja

Numri I shqiptarëve në botë mendohet se arrin shifrën 8,477,000. Shumica prej tyre banojnë në Shqipëri (3,200,000) dhe në Kosovë (2,000,000). Me qindra mijëra shqipëtar kemi edhe në Maqedoni (524,258) , Turqi (500,000) , Greqi (438,036) , Gjermani (400,000) , Itali (348,813) , Britani e Madhe (300,000) , në SHBA (250,000) , në Zvicër (200,000) , si dhe në shumë vende të tjera nëpër botë. ¹ Të gjithë shqipëtarët kanë tradita dhe zakone të përbashkët, një të kaluar sa të përvuajtur, aq edhe të lavdishme. Por, gjëja më e çmuar që i lidh të gjithë shqipëtarët dhe që me dashuri dhe shumë sakrificë e kanë ruajtur ndër shekuj është gjuha shqipe. Për vlerat e larta që ka gjuha jonë nuk ka nevojë të flasim, ajo këto i dëshmon vetë . Bukurinë e të folurit çdo shqipëtar e ndjen në tingujt e fjalëve SHQIPE .

Gjuha letrare , bashkë me dy dialektet – tosk dhe gegë , si dhe nëndialektet e saj e përbëjnë gjuhën shqipe. Studiuesit tanë të mëdhenj kanë shprehur shumë mendime për çështjen e gjuhës standarde, ndër të cilët Gj.Shkurtaj thotë se *“me lindjen dhe formimin e gjuhës letrare kombëtare , dialektet paraqiten brenda gjuhës së përbashkët si mbeturina të fazave të mëparshme parakombëtare të gjuhës, kurse gjuha letrare paraqitet si mbikrahinore dhe si shkalla më e lartë e zhvillimit”*².

Gjuha që sot ne përdorim për të komunikuar – qoftë drejtëpërdrejtë qoftë me shkrim , është standardizuar në Kongresin e Drejtshkrimit , në vitin 1972 në Tiranë. Pjesë nga dy dialektet janë të pranishme në gjuhën standarde ose letrare, por si dialekt bazë është marr dialekti tosk . Si e tillë, ajo duhet të zbatohet nga të gjithë shqipfolësit, me anë të cilës do të kishim mundësi t’i shmangim vështirësitë në komunikim mbarëkombëtar.

¹ Informacioni I marrur nga faqja wikipedia.org/wiki/Shp%C3%ABrndarja_e_shqiptar%C3%ABve#cite_note-1 , e qasur me datë 24.10.2019

² Gjinari , Jorgji , & Shkurtaj, Gjovalin, “Dialektologjia”, Tiranë, 2003, f.245

Pra, ajo që ne duhet të bëjmë si shqipëtar në radhë të parë, e vecanërisht ne mësimdhënësit është që gjuhën tonë t'a përdorim siç është vendosur në Kongresin e Drejtshkrimit , dmth gjuhën standarde. Përveç se duhet ta respektojmë normën drejtshkrimore, duhet t'i kushtojmë rëndësi drejtshqiptimit të fjalëve. Shqiptimin standard të fjalëve në gjuhën shqipe e studion drejtshqiptimi.³

Në këtë punim do të trajtojmë një problem shumë të rëndësishëm – mospërdorimi i gjuhës standarde shqipe në shkolla . Është e pamundur t'a bëjmë një hulumtim në të gjitha shkollat shqipëtare – pasi që ashtu punimi do të bëhej me përmasa shumë të mëdha , por shpresa që një gjë të tillë në të ardhmen edhe mund të realizohet nga një grup më të madh studiuesish akoma egziston.

Në këtë hulumtim bëjnë pjesë dy shkolla në qytetin ku jetoj – Istog. Ato janë shkolla fillore “Bajram Curri “ dhe gjimnazi “Haxhi Zeka”. Në qytetin e Istogut këto janë të vetmet shkolla për momentin. Problematika që do të trajtohet në hulumtim është mospërdorimi i gjuhës standarde shqipe nga ana e mësimdhënësve në këto dy shkolla.

Pas disa anketime dhe pyetësor të realizuar me mësimdhënësit kemi arritur të mbledhim të dhëna të mjaftueshme për t'a realizuar këtë hulumtim deri në fund. Në shkollën fillore “Bajram Curri “ kemi mësimdhënës të cilët realizojnë mësimin parashkollor, fillor (nga klasa e parë deri në klasën e pestë) dhe fillor të lartë (nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë) , ndërsa në gjimnazin “Haxhi Zeka” kuptohet se mësimdhënësit realizojnë vetëm mësim parauniversitar ose të shkollës së mesme.

Arsyeja pse kemi zgjedhur të dyja shkollat për këtë lloj të hulumtimit është se të dyjat kanë shumë rëndësi – e para është një vend ku nxënësit marrin mësimet e para në jetë, hedhin hapat e parë drejtë arsimimit të mëtejshëm dhe meritojnë që kjo të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme – dhe kjo patjetër që realizohet vetëm nga një staf të mirëfilltë dhe shumë të përgatitur nga aspekti profesional , ku patjetër duhet të jetë e përdorur gjuha letrare në komunikim me nxënësit.

³ Dodi , Anastas , “Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe” , Tiranë , 2004 , f.28

Shkolla e dytë – e mesme, gjimnazi “Haxhi Zeka”, është vazhdim i shkollës fillore, ku nxënësit tashmë kanë krijuar shprehinë e të mësuarit dhe idenë e të qenurit nxënës. Por, rëndësia e mësimdhënies kualitative në këtë shkollë, gjithmonë duke përdorur gjuhën letrare në komunikim me nxënësit, qëndron në faktin se prej këtij mjedisi, në një të ardhme të afërt shumica e nxënësve nuk do të jenë më nxënës, por do të bëhen student.

Nëse mësimdhënësit komunikojnë me nxënësit duke përdorur gjuhën letrare, në njëfarë mënyrë ata do të jenë më të përgatitur për mjedisin e ri që i pret (kuptohet, nëse zgjedhin që të studiojnë në njërin nga universitetët ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe), kjo do t’ua lehtësonte komunikimin me profesorët universitar, si dhe me kolegët të cilët mund të vijnë nga trevat e ndryshme shqiptare.

Mësimdhënësit duhet t’a marrin më me seriozitet këtë problem, pasi që të gjitha proceset mësimore janë të lidhur si zinxhir, ku mungesa e një “halkë” të tij mund të jetë dëm për të ardhmen e nxënësve. Është shumë me rëndësi që mësimdhënësit t’a zotojnë dhe t’a përdorin gjuhën standarde, pavarësisht në cilin prej vendeve shqiptare jetojnë dhe veprojnë. Në hulumtimin tonë, i cili është realizuar në qytetin e Istogut, në dy shkollat e lartpërmendura, kanë marr pjesë 103 mësimdhënës, prej të cilave 52 të shkollës fillore dhe 51 të gjimnazit.

Në qendër të këtij punimi mund t’i shohim rezultatët e punës tonë, përgjigjet nga pyetësorët dhe anketimet, çfarë mendojnë mësimdhënësit e këtyre shkollave në lidhje me këtë problematikë, si dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e çështjes në fjalë, si dhe gabimet drejtskrimore të tyre.

2.Lënda e hulumtimit

Në qendër të këtij punimi me temë “Përdorimi i gjuhës shqipe standarde në shkollën fillore dhe të mesme në Istog” kemi vënë shkallën e përdorimit të gjuhës tonë, gjuhës shqipe standarde, në institucionet arsimore ose shkollat në qytetin e Istogut, Kosovë. Objekti i punimit është që të analizohet shkalla e përvetësimit dhe përdorimit të gjuhës standarde nga ana e mësimitdhënësve të këtyre institucioneve. Duke pasur parasysh ngjarjet e para dy dekadave në tërë territorin e Kosovës, e nënkuptojmë edhe gjendjen në të cilën edhe sot e kësaj dite ndodhen këto institucione, lufta ka lënë gjurmë të thella dhe në pjesën e arsimit. Por, mos të harrojmë se edhe ndryshimet më të mëdhaja dhe pozitive nisin me hapin e parë, pra me rëndësi të madhe është që të paktën të kemi përpjekje, sado të vogla të jenë, për të përparuar në këtë aspekt, i cili ka rëndësi mbarëkombëtare . Me anë të këtij hulumtimi do të pasqyrojmë të folurit e mësimitdhënësve në hapësirat e shkollave, në komunikim me nxënësit gjatë mësimitdhënies dhe gjatë kohës jashtë mësimitdhënies (ligjërimit), dhe sa afër jemi me përdorimin e standardit.

3.Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të kuptojmë nëpërmjet metodave të ndryshme nëse mësimitdhënia zhvillohet duke përdorur gjuhën standarde, sa rëndësi i jepet kësaj problematike nga ana e institucioneve, dhe sa nxënësit janë në gjendje që ta kuptojnë ligjërimitin në gjuhën shqipe standarde. Përdorimi i gjuhës standarde ka peshë të madhe për mbarë kombin dhe duhet përdorur nga të gjithë, e sidomos nga ne, mësimitdhënësit.

Një studim si ky nuk është bërë deri më tani në këto shkolla, shkaqet mund të jenë mospërqendrimi në këtë aspekt problematik ose përfundimi i studimit – që del se në institucionet shkollore të këtij vendi nuk përdoret gjuha standarde në nivelin e duhur.

Siç e kemi lexuar dhe dëgjuar, të parët tanë kanë bërë një “rrugëtim” të gjatë derisa e kanë standardizuar gjuhën. Shumë njerëz të dijes dhe atdheut, janë përpjekur që të vije deri të standardizimi i gjuhës shqipe, me qëllim që të jetë e kuptueshme dhe e zbatueshme për të gjithë ne, gjë që na mundëson komunikim më të lehtësuar, dhe nuk duhet asesi të neglizhohet nga mësime dhënësit.

4.Hipotezat

Duke u bazuar në qëllimin e këtij studimi, pyetjet me rëndësi do të jenë si vijojnë:

1. Sa përdoret gjuha standarde shqipe në shkollat e qytetit të Istogut ?
2. Sa e kuptojnë nxënësit e shkollës fillore gjuhën standarde?
3. Sa e kuptojnë nxënësit e shkollës së mesme gjuhën standarde?
4. A është më prezente e folura e vendit apo gjuha standarde në këto institucione?
5. A ndikon negativisht rrethi / kolegët në përdorimin e gjuhës standarde tek mësime dhënësit?
6. A është problemi më i madh mosnjohja e gjuhës standarde nga ana e mësime dhënëseve?
7. A gabojnë mësime dhënësit në drejtshkrimin e termave të thjeshta?

5. Metodologjia e hulumtimit

Siç edhe e kemi parë më lartë, në qendër të punimit janë mesimdhënësit. Për ta kuptuar shkallën e përdorimit të gjuhës standarde nga ana e tyre, kemi përdorur metodën e mbledhjes së të dhënave, analizën e të dhënave, metoda vëzhguese, procesin e intervistave dhe anketimeve, formulimin e pyetësorëve të cilët kanë luajtur rolin kryesor në tërë procesin e formulimit të kësaj teze. Nëpërmjet disa pyetësorëve të realizuar kemi mbledhur të dhënat kryesore të punimit, edhe atë për çështjet kryesore që na interesojnë: drejtshkrimi dhe interesimi i mesimdhënësve për ta përdorur gjuhën standarde. Metoda krahasuese gjithashtu ka zënë vend në punim, e cila është përdorur për t'i krahasuar rezultatet e përgjigjeve nga mesimdhënësit e të dy shkollave (filllore dhe e mesme).

6. Rëndësia e punimit

Roli i këtij punimit është që të ngrisë vetëdijësimin e mesimdhënësve në aspektin e komunikimit me nxënësit. Çështja e përdorimit të gjuhës standarde ose letrare nuk është problem i vogël dhe momental – këta nxënës të sotëm janë e ardhmja, dmth studentët e së nesërmes, nëpunësit e së ardhmes. Nëpër shkollat e vendit ndoshta nuk i kushtohet aq rëndësi kësaj problematikës , siç mund t'i shohim edhe rezultatet nga hulumtimi i bërë , por mendoj se nuk duhet të ketë mesimdhënës të cilët nuk e zotojnë gjuhën letrare – siç ka thënë edhe gjuhëtari i njohur Xhevat Lloshi , pasi që ndikimi i tyre tek nxënësit është shumë i madh, ata në këto insitucione i marrin mësimet e para, hedhin hapat e parë drejtë arsimimit të mëtejshëm. Ne, mesimdhënësit, patjetër duhet ta përdorim gjuhën standarde, e cila ka shumë anë pozitive, këtë shembull e shohim edhe nga shtetet e zhvilluar ku nuk mund të ligjerojë një mesimdhënës i cili nuk e zoton gjuhën letrare të vendit në nivel të duhur.

7. Qyteti i Istogut

Istogu gjendet në pjesën veriperëimore të Republikës së Kosovës, në zonën e Rrafshit të Dukagjinit lindor. Duke u nisur nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, për të arritur në Istog duhet të kalojmë rreth 82 km. Vija ajrore mes Prishtinës dhe Istogut është rreth 56 km. Nisemi në perëndim të Prishtinës, duke kaluar edhe qytetin e Fushë Kosovës dhe kyçemi në autostradën M9, me infrastrukturë rrugore moderne, që e bën udhëtimin e këndshëm, duke na ofruar njëkohësisht pamje të cilat janë kryesisht rrafshina të gjelbëruara të cilat të mahnisin duke i shikuar. Nëse kaloni përgjatë kësaj rruge, nuk mund të mos i vëreni bukuritë e rralla natyrore të një rrafshinë e cila shtrihet në një hapësirë me përmasa të mëdha.



Duke vazhduar në perëndim të Prishtinës, pas rreth 1 orë arrijmë në Rrafshin e njohur të Dukagjinit, ku me të hyrë duhet të nisemi në veri, ku e kalojmë komunën e Klinës dhe më në fund arrijmë në komunën e Istogut. Për dallim nga rrafshi i deritanishëm, në këtë komunë fillojnë të duken malet e Moknës nga pjesa veriore, të cilat arrijnë lartësinë prej 2.155 m.⁴

Kjo hapësirë është e njohur edhe me emrin Podguri, një nën-krahinë etnografike që zënë pozitën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Pozita gjeografike, klima e Istogut, bashkë me bukuritë natyrore që ka, kanë qenë faktorët pse Istogu ka qenë i banuar nga lashtësia⁵, për të cilën dëshmojnë gjetjet nga kërkimet dhe gërmimet e shumta në këtë komunë të cilët datojnë nga periudha të lashta (parahistorike, antike dhe mesjetare).⁶

⁴ "Plani lokal I veprimit në mjedis 2012/2017", Komuna e Istogut, 2012, f.19

⁵ Ibid, f.19

⁶ Mehmetaj, Haxhi, "Trashëgimia arkeologjike e komunës së Istogut", Prishtinë, 2016, f.11

Komuna e Istogut përfshin një hapësirë prej 45.385 km^2 , 51 fshatra dhe qyteti, në të cilët sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë në prill të vitit 2011, jetojnë 39.294 banorë – 90% e të cilëve janë shqipëtar⁷, pjesa më e madhe të të cilëve jeton në fshatra dhe rreth 30% në qytetin e Istogut.

Në vitin 2004, dr. Jusuf Osmani, mes shumë botimeve tjera që ka bërë për të gjithë vendbanimet e Kosovës, ka botuar një vepër për Komunën e Istogut dhe vendbanimet e saj. Osmani I ka shkruar emrat e fshatrave shqip në klapa . Këto emërtime I ka propozuar një organizatë joqeveritare pas luftës së fundit në Kosovë . Në vijim kemi emrat e të gjitha fshatrave të Istogut , të cilat janë aktualisht dhe emërtimet e tyre shqip, shumica e të cilave nuk përdoren sot :

1. Baja
2. Banjica (Banjëza)
3. Belica
4. Bellopoja
5. Cerrca
6. Cërkolezi
7. Carralluka (Fushëmira)
8. Dobrusha (Drenusha)
9. Dragoleci
10. Dreja
11. Dubova E Vogël (Driloni I Vogël)
12. Dubrava (Drejana)
13. Gurrakoci
14. Gusari
15. Istogu
16. Istogu I Poshtem



⁷ Mehmetaj, Haxhi, “Trashëgimia arkeologjike e komunës së Istogut”, Prishtinë , 2016 , f.13

- 17.Kaliqani
- 18.Kamenica (Temali)
- 19.Kashica (Drinasi)
- 20.Kërnina
- 21.Koshi
- 22.Kovraga (Krasniqaj)
- 23.Lubova (Thana)
- 24.Lubozhda (Nëngurra)
- 25.Lluga (Verrishta)
- 26.Llukafci I Begut (Begaj)
- 27.Llukafci I Thatë
- 28.Mojstiri
- 29.Muzhevina (Muzakaj)
- 30.Orrobërda (Arbana)
- 31.Osojani
- 32.Padalishta (Pemishtja)
- 33.Polana (Fushëpali)
- 34.Prekalla
- 35.Prigoda
- 36.Rakoshi
- 37.Staradrani (Dasam)
- 38.Sudenica (Gurrasi)
- 39.Suhogërlla (Syrigana))
- 40.Shalinoci (Shala)
- 41.Shushica (Gashaj)
- 42.Syneja
- 43.Tomoci
- 44.Trubuhovci (Osmanaj Niti)

- 45. Tuqepi
- 46. Uça
- 47. Veriqi (Vërrini)
- 48. Vrella (Tedeli)
- 49. Zabllaci (Frashni)
- 50. Zallci
- 51. Zhakova (Dardha).⁸

Si qendra më urbane në komunën e Istogut , përveç zonës së qytetit , konsiderohen edhe fshatrat Gurrakoci, Vrella dhe Banja, me numër të konsiderueshëm banorësh (mbi 3.000 banorë).⁹ Në Istog mbizotëron klima e butë kontinentale, ku temperatura mesatare në muajin janar është -0.5 ‘C dhe në gusht 23.3 ‘C, e cila ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë (popullësia merret me kultivimin e drithërave, pemë dhe perime).

Të mos harrojmë të përmendim se komuna e Istogut përshkohet nga lumi Drini i Bardhë, burimi i Istogut, burimi i Vrellës , të cilët ndihmojnë shumë në zhvillimin e bujqësisë, por edhe në prodhimin e peshkut kryesisht të llojit trofta, një biznes i cili lulëzon në Istog falë kushteve klimatike të përshtatshme dhe ujit të pastër .

Kur flasim për klimën e Istogut , patjetër duhet përmendur erërat me intensitet të lartë (27 m/s), që mendohet se janë me intensitet më të lartë në Gadishullin Ilir, të cilët fryjnë zakonisht nga drejtimet perëndimore dhe jugperëndimore, të cilët me shpejtësinë e tyre shpeshherë shkaktojnë dëme materiale në qytet. ¹⁰

⁸ Osmani, Jusuf, "Vendbanimet e Kosovës – Burimi (Istogu)", Prishtinë, 2004 .

⁹ " Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017/2021", Komuna e Istogut, f.16

¹⁰ Ibid, f.24

Istogu nuk ofron shumë sa i përket turizmit , gjë që nënkuptohet edhe nga gjendja e ulët ekonomike të komunës, por kjo nuk do të thotë se mungojnë potencialet për zhvillim të kësaj dege në të ardhmen . Pasuritë natyrore , me peizazhe përrallore në Bjeshkët e Istogut, Moknës si dhe Bjeshkët e Nemuna mund të shëndrrohen në hapësira me qendra pushimi, si për stinën e verës , ashtu edhe për dimrin, ku mund të organizohen aktivitete të ndryshme dhe sporte në natyrë , në ajër të pastër , që do të ishin në dobi të shëndetit të qytetarëve por edhe vizituesve të jashtëm, por edhe do ta ndihmonin rritjen ekonomike dhe do të hapnin vende të reja të punës për të rinjtë në këtë komunë .

Ndër problemet kryesor për qytetarët e komunës janë: zhvillimi i ulët ekonomik, shkalla e lartë e papunësisë (vetëm 36% të popullsisë janë të punësuar), gjë që shkakton largimin e njerëzve të rinj dhe intelektual nga komuna, shtrirja e komunës larg arterieve kryesor të shtetit si dhe prej komuneve fqinjë , buxhet të pamjaftueshëm të komunës për përkrahje të bizneseve ekzistuese si dhe për hapjen e vendeve të reja të punës, infrastrukturë e pamjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive , fatkeqsitë natyrore, por edhe probleme themelore për një jetesë normale, siç janë : mungesë e rrugëve rurale dhe lokale, mungesë e ujësjellsit dhe kanalizimit në shumë fshatra , mungesë e hapësirave të gjelbëruara (nuk ka asnjë park në qytet), gjë e cila ndikon direkt tek shëndeti i qytetarëve, mirëmbajtja e qytetit dhe pastrimi i mbeturinave, në qendrat mjekësore mungesë të pajisjeve të nevojshme , mungesë e shërbimeve komunale të të gjitha llojeve . ¹¹

¹¹ “ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017/2021”, Komuna e Istogut, f.39

8.Arsimimi dhe institucionet arsimore të qytetit

Në kuadër të Komunës së Istogut funksionojnë disa drejtori, ndër të cilave edhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, e cila është përgjegjëse për të gjitha proceset edukativo – arsimor, për zbatimin e rregullave të vendosur nga Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjive të Kosovës.¹² Zyra e drejtorise gjendet në objektin komunal të Istogut dhe funksionon në mënyrë të pandërprerë , duke u kujdesur që t’i organizojë dhe menaxhojë të gjitha aktivitetet- përveç arsimore, edhe kulturore, rinore dhe sportive . Në vazhdueshmëri kjo drejtori mbikqyr institucionet edukativo – arsimore dhe kryen detyrat dhe obligimet e veta në përputhje me ligjet dhe rregullat. Në këtë komunë , institucionet shkollor janë të organizuar në:

- 5 kopshte për fëmijë,
- 11 shkolla amë nëntëvjecare,
- 15 paralele të ndara për shkollim fillor,
- 2 shkolla të mesme ,
- 1 paralele e ndarë profesionale.

Kopshtet për fëmijë në komunën e Istogut janë: “Gëzimi ynë” , “Lulet e jetës” , “Shpresa jonë” , “Ardhmëria jonë” , “Pëllumbat e ardhmërisë” , në të cilët numri i nxënësve është 174¹³.

Shkollat në të cilat nxënësit ndjekin mësim në ciklin fillor janë :

- “Bajram Curri” , paralelet e ndara “Bajram Curri” -1 në Cerrcë , “Bajram Curri” – 2 në Muzhevinë, “Bajram Curri” – 3 në Dubravë ;
- “Hysni Zajmi” , paralelet e ndara “Hysni Zajmi” - 1 në Prigodë, “Hysni Zajmi” – 2 në Studenicë ;
- “Martin Camaj” , paralelja e ndarë “Martin Camaj” – 1 në LLukavc i Thatë ;

¹² “ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017/2021”, Komuna e Istogut, f.34

¹³ Ibid

-“Trepça”;

-“Ndre Mjeda” , paralelet e ndara “Ndre Mjeda” – 1 në Veriq, “:Ndre Mjeda” – 2 në Kërrninë;

-“Ismail Qemajli”, paralelja e ndarë “Ismail Qemajli” - 1 në Trubohocë;

-“Avni Rrustemi”, paralelja e ndarë “Avni Rrustemi” – 1 në Kosh,;

-“Fan S Noli” , paralelja e ndarë “Fan S Noli” – 1 në Dobrushë ;

-‘Tre Dëshmorët”, paralelet e ndara “Tre Dëshmorët” -1 në Padalishtë dhe “Tre Dëshmorët” – 2 në Cerkozë;

-“Zymer Zeka”

-“Mehmet Akifi”, paralelja e ndarë “Mehmet Akifi” në Shoshicë e Ultë);¹⁴

- Paralelja e ndarë e SHMT profesionale “Rudina” në Burgun e Dubravës;

Në këto shkolla, në arsimin parashkollor janë 235 nxënës në sistemuar në 15 grupe, në arsimin fillor – prej klasës së parë deri në klasën e nëntë numri i nxënësve është 7251 në 308 paralele , si dhe 18 nxënës me nevoja të veçanta në dy klasa.

Shkollat e mesme janë gjimnazi “Haxhi Zeka” në Istog dhe shkolla e mesme teknike “Mithat Frashëri “ në Gurrakoc, në të cilat ndjekin mësimin 2273 nxënës ose 70 paralele ¹⁵.

10 prej këtyre shkollave janë të pajisur me kamera monitoruese , që iu ofron siguri më të lartë nxënësve . Në të gjithë komunën e Istogut numri i mësimdhënësve është 518.¹⁶

¹⁴ Informacion I marrur nga faqja <https://kk.rks-gov.net/istog/dreitorite/dreitoria-e-arsimit/> , “Lista e shkollave me kamera (Excel document)” , e qasur me date 29.10.2019

¹⁵ “ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017/2021”, Komuna e Istogut, f.34

¹⁶ Ibid

II. Kapitulli i dytë

1.Shkolla fillore “Bajram Curri”

Shkolla e sotme fillore “Bajram Curri” është themeluar në vitin 1918¹⁷ në qytetin Istog, dhe në atë kohë e ka mbajtur të njëjtin emër si sot.

Në vitin 1958 , është ndërruar emri I kësaj shkolle nga regjimi politik I asaj kohe dhe është quajtur “17 Nëntori”¹⁸.



Prej hapjes e deri në vitin 1990 , mësimi në këtë shkollë është zhvilluar në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Në vitin 1992 , gjuha serbe është hequr përfundimish nga përdorimi për ligjerim tek nxënësit shqipëtar në këtë shkollë dhe mësimi është zhvilluar vetëm në gjuhën shqipe, me planprogram I kujtuar nga vetë mësuesit shqipëtar të Kosovës¹⁹.

Por, pas kësaj, në objektet shkollor nuk është lejuar që të mbahet mësim për nxënësit kosovar, dhe mësimdhënësit dhe udhëheqësit e arsimit në atë kohë kanë qenë të detyruar që mësimin ta zhvillojnë në të ashtuquajturat shtëpi-shkolla, të cilat kanë qenë prona private, pronarët e të cilave me vetë dëshirë ia kanë ofruar nxënësve dhe mësimdhënësve t’i shfrytëzojnë si klasa për aq periudhë kohore sa të jetë e nevojshme.²⁰

¹⁷ Arkivi I Shkollës “Bajram Curri”, Istog, qasja me datë 18.09.2019

¹⁸ Ibid

¹⁹ Ibid

²⁰ Ibid

Nga themelimi , përveç në shkollën amë e cila gjendej në qytet, mësimi është mbajtur edhe në katër paralele të ndara në fshatrat Cerrcë, Muzhevinë, Dubravë dhe fshatin Synajë, për shkak të distancës së këtyre vendbanimeve nga shkolla amë, gjë që ka qenë një lehtësim i madh për nxënësit të cilët nuk i kanë patur mjetet e transportit si sot, por nga ana tjetër edhe rrezikshmërinë që ka paraqit udhëtimi i fëmijëve deri në shkollën për shkak të rrehanave të luftës së ashpër mes dy popujve, të cilët kanë patur ndjenën e urrejtjes së theksuar mes vete.

Vështirësi të shumta kanë patur edhe mësimdhënësit , të cilët shpeshherë kanë vuajtur dënime për shkak që e kanë ushtruar profesonin e vet në gjuhën e vet. Gjatë viteve të luftës , siç dihet , pothuajse e gjithë popullsia e qytetit është zhvendosur në Mal të Zi, ku nxënësit e kanë vazhduar mësimin pjesërisht në shtëpi-shkolla, dhe pjesa tjetër në objektet shkollor të vendit, ku me marrëveshje kanë përshtatur oraret e mësimi, i cili zhvillohej në gjuhën shqipe.

Pas përfundimit të luftës së fundit në 1998/99, qytetarët janë rikthyer në vendlindje. Duke e marr vetën ngadalë pas shkatërrimit pothuajse total që ka lënë lufta pas, kanë arritur për një kohë relativisht të shkurtër ta rifillojnë procesin mësimor dhe me vullnet të madh ta kompenzojnë kohën e humbur.

Në vitet e para pas luftës, sipas statistikave të arkivit të shkollës “Bajram Curri” , kemi patur numrin më të madh të nxënësve ndonjëherë . Në vitin shkollor 2005/06 , numri i nxënësve në këtë shkollë ka arritur deri te 2092²¹. Në këtë periudhë paslufte, kanë funksionuar paralelet e ndara në katër fshatrat e lartpërmendur deri në vitin 2017, kur paralelja në fshatin Synajë është mbyllur për shkak të numrit shumë të vogël të nxënësve. Lufta ka lënë gjurmë në të gjitha sferat e jetës në Kosovë në përgjithësi, ku papunësia ka qenë edhe është edhe sot e kësaj dite një ndër problemet kryesorë, për shkak të cilit shumë familje vendosin të braktisin vendlindjen dhe të zhvendosen në ndonjërin prej shteteve perëndimore, ku e gjejnë vetën , gjejnë një vend pune të qëndrueshme, që t’i sigurojnë vetës dhe familjës një jetesë më të mire dhe një të ardhme më të sigurtë.

²¹ Arkivi i Shkollës “Bajram Curri”, Istog, qasja me datë 18.09.2019

Po ta përmendim edhe shendetësinë si njëra prej institucioneve të rëndësishme për njeriun, duhet thënë se në Istog funksionaliteti i saj nuk është në nivel të kenaqshëm, gjë që bën të largohen qytetarët , qoftë në qytetet më të mëdhenj , qoftë jashtë shtetit.

Për dallim nga kjo, udhëheqësit në shkollë kanë bërë hapa të duhur drejtë përcaktimit të personelit profesional që punon në shkollën “Bajram Curri”. Në këtë shkollë , në vitin shkollor 2018/19, periudha në të cilën është bërë ky hulumtim, , numri i mësimitdhënësve të cilët punojnë në ciklin fillor të ulët ka qenë 40 , të ciklit fillor të lartë ky numër ka qenë 46. Në krye të udhëheqëjes kemi drejtorin e shkollës, pastaj zëvendës drejtorin, punëtori për çështje administrative dhe psikologu i shkollës.²² Kur flasim për pedagogët dhe psikologët e shkollave, qoftë ajo fillore apo e mesme, ata janë të duhurit të cilët duhet të angazhohen sa më shumë me nxënësit ,sepse në ditët e sotme nxënësit janë shumë të ngarkuar me përmbajtje mësimore dhe obligime shkollore të shumta, pa e përmendur ngarkesën të cilën e kanë duke i lejuar që vazhdimisht të jenë të eksploruar ndaj teknologjisë moderne , e cila në ditët e sotme është pothuajse e pashmangshme. Psikologët duhet të kenë përgatitje profesionale të duhur për të punuar me nxënësit e sotëm, sepse *këto janë fusha shumë të rëndësishme dhe aktuale të psikologjisë dhe pedagogjisë, por janë të prekur më së paku. Ne, p.sh. dime më së paku për psikologjinë e fëmijëve shqipëtar të moshës gjashtë – shtatë vjeçare, element ky shumë i rëndësishëm për kohën e fillimit të shkollimit*²³.

Biblioteka e shkollës, me një bibliotekiste, funksionon në shërbim të nxënësve. Për bibliotekën duhet thënë se është e pasur me materialet e nevojshme të cilët përmbushin nevojat e nxënësve. Këtë e kanë shprehur edhe vetë nxënësit gjatë një anketë të shkurtër²⁴ , ku në pyetjen se a i ka biblioteka librat ose titujt e veprave të cilët i kërkojnë , 84 % janë përgjigjur me *PO*, ndërsa një përqindje e vogël (10%) , kanë thënë se *JO*, biblioteka nuk i posedon librat të cilat i kërkojnë për t’jua huazuar. Një numër i vogël nxënësish (6%), kanë thënë se në bibliotekë gjejnë vetëm librat të cilat l’u propozojnë mësimitdhënësit për t’i lexuar.

²² “Planprogrami zhvillimor dhe mësimor i shkollës fillore “Bajram Curri” për vitin shkollor 2018/19” , Istog, qasja me datë 16.05.2019

²³ Rexhepagiq, Jashar, “Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike”, Prishtinë, 2002, f.249

²⁴ Anketimi është realizuar me datë 15.05.2019, në shkollën fillore “Bajram Curri”,Istog

Të gjithë nxënësit e kësaj shkolle, numri I të cilëve gjatë vitit shkollor 2018/19 ka qenë 1589, kanë qenë të sistemuar në gjithsej 69 paralele. Në shkollën amë në Istog ka patur 21 paralele në ciklin e ulët dhe një paralele speciale. Në fshatin Cerrcë ka patur 5 paralele, në fshatin Muzhevinë 5 paralele dhe në fshatin Dubravë ka patur 6 paralele. Në ciklin parafillor në këtë vit shkollor ka patur vetëm 2 klasa, që tregojnë për rënien e vazhdueshme të numrit të nxënësve. Në ciklin fillor të lartë (prej klasës së 6 deri në klasën e 9) , nxënësit kanë qenë të sistemuar në 29 paralele. Nxënësit të ciklin fillor të lartë në “Bajram Curri” e ndjekin mësimin sipas orarit të paraditës, ndërsa ata të ciklit të ulët e ndjekin mësimin pasdite. Në dispozicion të nxënësve janë edhe sallat sportive të pajisur sipas standardeve bashkëkohore, të cilat i plotësojnë kushtet për zhvillimin e sporteve të ndryshme.

Për mirëmbajtjen dhe higjienën e shkollës, gjë e cila duhet të jetë në nivel për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe për kujdesin ndaj shëndetit të tyre, kujdesen 11 persona,ndërsa për sigurinë në shkollë kemi dy roje.²⁵ Shkolla fillore është rindërtuar tërësisht dhe vitet fundit mësimi zhvillohet në hapësirat e objektit të ri shkollor , i cili ka kushte të përshtatshme për nxënësit dhe mësimdhënësit. Të gjitha këto të dhëna të lartëpërmendura , të cilat i kemi siguruar nga Arkiva dhe Zyra administrative e shkollës, na bëjnë të ditur se shkolla fillore në qytetin e Istogut e ka një organizim të rregulluar mire. Por , kjo nuk është çështja kryesore e këtij hulumtimi .

Ajo që na intereson të hulumtojmë është : Sa cilësor është mësimi në këtë shkollë ? Dhe më e rëndësishmja për neve : Sa përdoret gjuha standarde shqipe nga mësimdhënësit e kësaj shkolle? Përgjigjet e këtyre pyetjeve do t’i shohim në kapitujt në vijim.

²⁵ Zyra Administrative e shkollës fillore “Bajram Curri”, Istog , informacion I marrur me datë 16.05.2019

2. Përdorimi I gjuhës shqipe standarde në shkollën “Bajram Curri”

Në ditët e sotme, gjuha e vetme në të cilën zhvillohet mësimi në këtë shkollë është gjuha shqipe. Mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës I përkasin nacionalitetit shqipëtar. Çështja e përdorimit të gjuhës shqipe gjatë mësimdhënies , për dallim nga dikur, sot nuk është problem në këtë shkollë. Të gjithë mësimdhënësit e shkollës janë me përgatitje profesionale të duhur, dmth kemi profesor të mësimit klasor, profesor të lëndëve të ndryshme të diplomuar, madje edhe të magjistruar dhe të doktoruar në fushën e vet. Në shkollën fillore “Bajram Curri” mbahen edhe aktivitete profesionale gjuhësore , të cilët organizohet nga ana e mësimdhënësve në bashkëpunim me nxënësit.

Gjatë kohës së ligjerimit me nxënësit , por edhe jashtë ligjerimit, vërejmë një “mangësi”, një moskujdesje , ose ndoshta edhe mosvetëdije për këtë gabim, I cili është mospërdorimi I gjuhës shqipe standarde. Edhe studiuesi I madh I gjuhës shqipe, Xhevat Lloshi, e konsideron këtë problem mbarëkombëtar I cili duhet zgjidhur patjetër. *“Të mos ketë më mësues të cilët nuk e zotojnë gjuhën standarde”* , ka thënë studiuesi jonë Xh. Lloshi gjatë një intervistimi.

Mospërdorimi I gjuhës standarde në komunikim me nxënësit , në rradhë të pare nuk duhet toleruar nga vetë mësimdhënësi. Në moshën e nxënësve të parashkollores dhe fillores të ulët, përveç mësimi, nxënësit duhet të pëgatiten edhe për disa parime të cilat do t’ju vlejné gjatë jetës. Ndër tjera, siç janë sjellja e mire, respekti ndaj mësimdhënësve, dashuria për librat, etj., ne duhet t’iu tregojmë për rëndësinë që ka gjuha jonë e njësuar, pse ka ardhur deri te njësimi I një gjuhe standarde dhe se ajo duhet përdorur njësoj nga të gjithë shqipfolësit, duke respektuar rregullat drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore.

Në mospërdorimin e gjuhës standarde shqipe nga ana e mësimit ndikojnë shumë faktor. Gjatë intervistimit, disa nga mësimit janë shprehur se ndoshta në vitet në vijim duhet formuar një gjuhë e re, që me shumë gjasa do të quhej “kosovarishtja”, gjë që do ta bënte të mundur që të gjithë ta kuptonin (është fjala për të gjithë nxënësit, mësimit, prindërit e nxënësve të cilët jetojnë në Kosovë). Ata thonë se gjatë ligjerimit ose gjatë komunikimit të lirë me nxënësit, shumë prej tyre nuk janë në gjendje që të kuptojnë çfarë l’u thotë mësimit. Përveç kësaj , është vërejtur edhe kur mësimit mundohen të komunikojnë duke përdorur gjuhën standarde të njësuar, gabojnë në mënyrën e shqiptimit të fjalëve (Gj.Shkurtaj është shprehur se : *shumë njerëz , edhe në stilin e shqiptimit libror , bien në shmangie nga norma letrare*²⁶).

Tjetri faktor është prejardhja ose familja e nxënësve. Në rrethin familjar nxënësit flasin në dialektin gegë, në të folurën verilindore të këtij dialekti. Përveç që nxënësit nuk e kuptojnë mjaftueshëm të folurën në gjuhën standarde, në takimet që realizohen me prindërit, ka patur ankesa nga ana e tyre, duke iu thënë mësimit të flasin më “thjeshtë”, në mënyrë që ata të kuptojnë më mire për çfarë bëhet fjalë. Këtu ndihet më shumë veprimi i dialekteve mbi gjuhën tonë standarde²⁷.

Edhe mes vetë kolegët mësimit ka shpeshherë mospajtime lidhur me përdorimin e gjuhës standarde. Kur dikush nga mësimit është munduar që të komunikojë me kolegët tjerë duke u shprehur me gjuhën shqipe standarde jo vetëm që nuk ka patur përkrahje, por edhe për një periudhë kohore ka patur tallje me fjalë të ndryshme, për të cilët nuk ka vend në një institucion edukativo-arsimor dhe tregon nivelin e papjekurisë deri diku, por edhe mosvlerësimin e rëndësishme që ka përdorimi i gjuhës standarde në institucione.


²⁶ Shkurtaj, Gjovalin, “Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe”, Tiranë , 2003 , f.1001

²⁷ Cabej, Eqrem , “Sudime gjuhësore” , Pishtinë , 1975, f.213


3. Paraqitja statistikore e rezultateve nga pyetësi i bërë në shkollën “Bajram Curri”

Në shkollën fillore “Bajram Curri” në Istog, gjatë vitit shkollor 2018/19, kemi realizuar një varg anketash dhe pyetësorësh me mësime të kësaj shkolle lidhur me hulumtimin tone ose tezën me titull “ Përdorimi I gjuhës standarde shqipe në institucionet arsimore në Istog” . Numri I mësime të cilët kanë vendosur që të japin përgjigjet e tyre në pyetësin me shkrim është 52. 19 prej tyre kanë dashur që të mbesin anonim, 11 kanë shkruar vetëm inicialet e emrit dhe mbiemrit, kurse 22 kanë shkruar emrin dhe mbiemrin e plotë.


Pyetjes së parë të këtij pyetësi , e cila ka qenë “A mendoni se në shkollën tuaj gjuha standarde shqipe përdoret mjaftueshëm?” , 18 mësime janë përgjigjur me *PO* (vetëm 35%) , kurse 34 me *JO* (65% e mësime të).




Pyetja e dytë ka qenë “A ndihmojnë mediat dhe rrjetet sociale në përvetësimin e gjuhës standarde?”, dhe 29 mësimdhënës ,ose 56 % janë shprehur se PO, mediat dhe rrjetet sociale ndihmojnë në përvetësimin e gjuhës standarde, ndërsa 23 (ose 44 %) kanë thënë se JO, mediat nuk ndihmojnë aspak në këtë çështje.




Në pyetjen e rradhës, “A ndikojnë rrjetet sociale në moslexim tek nxënësit?”, 47 (90%) mësimdhënës kanë thënë PO, ndërsa vetëm 5 (10%) JO .



Për çështjen e gjuhëve të huaja është parashtruar pyetja “Sa ndikojnë gjuhët e huaj , p.sh. gjuha angleze , në mospërdorimin e termave shqip?” , ku 24 (ose 46%) kanë thënë se gjuhët e huaja kanë ndikim shumë të madh, 25 mësimdhënës (ose 48%) thonë se ndikimi i gjuhëve të huaj është i vogël, dhe 3 (ose 6%) thonë se gjuhët e huaj nuk kanë aspak ndikim.




Mësimdhënësit e shkollës “Bajram Curri” gjithashtu kanë patur si pyetje në pyetësorin “Në cilin dialekt bazohet gjuha standarde shqipe?” dhe rezultatet janë për t’u çuditur. 31 mësimdhënës (59%) janë përgjigjur me *toskërisht*, 3 mësimdhënës (ose 6%) kanë thënë se gjuha standarde shqipe bazohet në dialektin *gegë* dhe 18 mësimdhënës (35 %) mendojnë se gjuha standarde shqipe bazohet në të *dy dialektet*.



Në pyetjen “Gjatë komunikimit me nxënësit, ju përdorni gjuhën shqipe të njësuar apo të folurën e vendit?”, 43 mësimdhënës (83%) kanë rrumbullakësuar opsionin *a) të folurin e vendit*, për arsyet që kemi përmendur më lartë (nxënësit nuk i kuptojnë jaftueshëm kur mësimdhënësit komunikojnë në gjuhën standarde), dhe vetëm 9 prej tyre (ose 17%) janë përgjigjur me *b) gjuhën e njësuar shqipe*.


6. Gjatë komunikimit me nxënësit, ju përdorni gjuhën shqipe të njësuar apo të folurën e vendit?



■ TË FOLURIT E VENDIT ■ GJUHËN E NJËSUAR SHQIPE

Se “Në çfarë mënyrë mund të përmirësohet të folurit në gjuhën standarde shqipe?”, 10 mësimdhënës (19 %) mendojnë se: a) me lexim të vazhdueshëm, 7 (14 %) b) me komunikim, dhe c) me të dyjat, kanë dhënë përgjigje 35 mësimdhënës (67 %).

7. Në çfarë mënyrë mund të përmirësohet të folurit në gjuhën standarde shqipe?



■ LEXIM ■ KOMUNIKIM ■ TË DYJAT

Gjatë anketimit të mësimitdhënësve , kemi vërejtur përdorimin e disa fjalëve që janë jashtë standardit të gjuhës shqipe , por që nga mësimitdhënësit përdoren shumë shpesh, prandaj kemi vendosur t'a bëjmë një pyetësor gojor të shpejtë . Kështu , ndajfolja mënyrore *si (në ç'mënyrë, në ç'gjendje)*²⁸ , 37 nga 52 mësimitdhënës e përdorin me ndajfoljen *qysh*; në vend se të jetë *t'a bëni (bëj- folje me kuptim të përgjithshëm që shpreh çdo lloj veprimi*²⁹) , 26 mësimitdhënës thonë *me i ba* ; për foljen *shikoj (hedh sytë në një drejtim, vështroj* ³⁰), 21 mësimitdhënës në hapësirat edukativo-arsimor në komunikim me kolegët dhe nxënësit e përdorin foljen *kqyr*. Gjatë anketimit , përemrat *vetor i jemi/i tina* në vend të formës *i imi/i atij*, e kanë përdorur 14 mësimitdhënës. Gjithashtu , përemrat *asajna/atina* në vend të *asaj/atij* e kemi dëgjuar nga 8 mësimitdhënës. Këto janë vetëm një pjesë e vogël të fjalëve të cilat kemi arritur t'i shënojmë , ndërsa në të folurin e përgjithshëm të mësimitdhënësve ka shumë të tillë.

²⁸ Fjalori I gjuhës shqipe, Tiranë, 1954, f. 490

²⁹ Ibid, f.35

³⁰ Ibid, f.522

4. Shkolla e mesme “ Haxhi Zeka”

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë janë krijuar kushte më të mira ekonomike, shoqërore dhe politike, nga të cilat kanë përfituar edhe shqipëtarët e Kosovës, të cilët deri në vitet e '40 ishin në një pozitë të vështirë nacionale në ish-Jugosllavinë . Ndër tjera, edhe shkalla e analfabetizmit të shqipëtarët ka qenë shumë e lartë në krahasim me popujt e tjerë.

Në dhjetor të vitit 1946, në Istog, është themeluar progjimnazi . Ky progjimnaz në fillim ka patur 25 nxënës. Themeluesi dhe drejtori në atë kohë ka qenë Abdurrahim Gashi. Progjimnazi ka funksionuar deri në vitin 1950, kur me reformat shkollore ,shkollat fillore kanë marr statusin e tetëvjeçares, dhe progjimnazi i Istogut mbeti në një vakuum të gjatë deri në vitin 1962/63, kur filloi të funksionojë përsëri , por këtë herë si paralele të ndara të cilët ishin pjesë e Normales në Pejë. Dega në Istog në vitin shkollor 1962/63 ka patur tre paralele me rreth 90 nxënës, në dy prej të cilave mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe , dhe në një paralele mësimi zhvillohej në gjuhën serbo-kroate. Nxënësit në këtë periudhë kanë ndjekur mësimet në hapësirat e objektit të vjetër të shkollës fillore “Bajram Curri” në Istog, i cili egziston edhe sot.³¹

Më vonë , në vitin shkollor 1964/65 , me ndarjen dhe pavarësimin nga Normalja e Pejës, shkolla u shëndrrua në gjimnaz. Objekti i ri shkollor i gjimnazit të Istogut është ndërtuar në vitin 1977 . Në këtë vit janë bërë edhe reformat e reja në arsim, me të cilat gjimnazi u transformua në Qendër të arsimit të mesëm të orientuar (QAMO).³²

Nxënësit në QAMO , përveç drejtimit të gjimnazit të përgjithshëm, aftësoheshin në drejtime ekonomike , juridike, fizioterapi, makineri, bujqësi, të tekstilit, të tregtisë, natyrore – teknike , etj. Deri në vitin 1990, QAMO ka patur dy objekte shkollore – njëri në Istog dhe tjetri në Gurrakoc. Këtë vit kanë filluar pengesat në arsim nga ana serbe në forma të ndryshme.³³

³¹ Arkivi I Gjimnazit “Haxhi Zeka”, Istog, qasur me datë 24.09.2019, f.2

³²Ibid

³³Ibid

I gjithë personeli , të gjithë mësimdhënësit bashkë me nxënësit shqipëtar kanë qenë të dëbuar nga shkolla e mesme “Haxhi Zeka “ në vitin shkollor 1991/92³⁴, dhe si pasojë e kësaj, kanë qenë të detyruar që mësimin ta vazhdojnë në shtëpitë – shkolla, njësoj sikur që ka ndodhur edhe me nxënësit e shkollave tjera në Kosovë në këtë periudhë. Vullneti i madh për të mësuar dhe përpjekjet e mësimdhënësve të asaj kohe kanë qenë të shumta. Pala serbe është munduar që ta pengojë mësimin edhe në shtëpitë – shkolla, prandaj vendndodhjet e tyre janë ndryshuar sheshherë, me qëllim që ta zhvillojnë mësimin pa pengesa. Edhe pse pa kushte elementare për ta zhvilluar mësimin, interesimi për t’u arsimuar ka qenë i madh dhe mësimdhënësit nuk kanë hequr dorë kurrë prej profesionit të vet.

Në vitin shkollor 1995 , gjimnazi është ndarë në dy shkolla të ndryshme, të cilat ekzistojnë edhe sot: në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog dhe shkollën e mesme teknike “Mithat Frashëri” në Gurakoc. Në kohën kur është ndarë gjimnazi , vetëm në gjimnaz ka patur 58 punëtor³⁵.

Gjatë këtyre viteve të paraluftës, shumë mësimdhënës kanë qenë të dënuar, të maltretuar në forma të ndryshme, nga ana psiqike por edhe shpesh kanë kaluar me lëndime të rënda fizike nga ana e policisë serbe. Përvec mësimdhënësit, lëndime fizike kanë përjetuar edhe shumë prej nxënësve të asaj kohe. Në vitin shkollor 1996/97, në prag të luftës, gjimnazi në Istog ka patur 32 paralele, ndërsa në vitin shkollor 1997/98 - 30 paralele ³⁶. Rënia e numrit të nxënësve është bërë për shkak të rethanave , pritej që të fillonte lufta. Shumica e nxënësve janë përgatitur që t’i shërbejnë ardeut, të shkojnë të luftojnë për shtetin e vet, ndërsa një pjesë e popullatës është shpërngulur në shtetet perëndimore.

³⁴ Arkivi I Gjimnazit “Haxhi Zeka”, Istog, qasur me datë 24.09.2019, f.3

³⁵ Ibid

³⁶ Ibid, f.5

Në shtëpitë – shkolla është mbajtur mësimi deri në vitin 1997, kur zyrat e drejtorisë dhe administratës janë vendosur përsëri në ndërtesën e vjetër të shkollës “Bajram Curri”, ku ka funksionuar deri me datë 22.03.1999. Me këtë datë Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës ka marr vendim që të ndërpritet mësimi në të gjitha shkollat e vendit për shkak të luftës.³⁷

Pas luftës , gjimnazi ka filluar me punë në objektin e gjimnazit, i cili ka qenë i ngritur në vitin 1977³⁸, dhe deri më sot funksionon pa pengesa.

Sot gjimnazi nuk ka paralele të ndara në vende tjera përvec shkollës amë në qytet (mund ta shohim në fotorafinë ngjitur). Numri i nxënësve të cilët kanë ndjekur mësimin në gjimnaz në vitin shkollor 2018/19 ka qenë 1056³⁹, të cilët kanë qenë të sistemuar në 33 paralele⁴⁰, ku mësimi zhvillohet vetëm



në gjuhën shqipe. Në këtë gjimnaz nxënësit mund të zgjedhin të ndjekin mësimin në profilin natyror ose shkencor.

Nga fillimi i punës , nga vitet 1964/65 e deri më sot , prej këtij gjimnazi kanë dalur me mijëra nxënës, për t'i vazhduar më pas studimet në universitete të ndryshme lokale dhe botërore , dhe mund të themi se shumë prej nxënësve tanë kanë patur suksese, janë bërë ekspert fusha të ndryshme. Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të cilët janë të punësuar në gjimnaz sot është 54, ndërsa në hulumtimin tonë kanë marr pjesë me përgjigjet e tyre 51 mësimdhënës.

³⁷ Arkivi I Gjimnazit “Haxhi Zeka”, Istog, qasur me datë 24.09.2019, f.5

³⁸ “Planprogrami mësimor I gjimnazit “Haxhi Zeka ” viti 2018/19” Istog, , qasur me datë 24.09.2019, f.1

³⁹ Ibid

⁴⁰ Ibid

5. Përdorimi I gjuhës shqipe standarde në gjimnazin “Haxhi Zeka”

Nga 54 mësime të cilët janë të punësuar në gjimnazin “Haxhi Zeka” në vitin shkollor 2018/19 , kemi patur mundësinë që të komunikojmë me 51 mësime të cilët kanë treguar gatishmërinë e tyre që t’i përgjigjen pyetjeve , nëpërmjet të cilave edhe u realizua ky hulumtim, i cili ka të bëjë me përdorimin e gjuhës standarde shqipe dhe përdorimi i saj nga ana e mësimeve. Në këtë gjimnaz, sikur edhe në shumicën e shkollave në Kosovë , sot e vetmja gjuhë e cila përdoret gjatë ligjerimit dhe jashtë tij është gjuha shqipe. Por , sa i respektojnë mësime të kësaj shkolle rregullat e gjuhës standarde në drejtshkrim dhe komunikim me nxënësit ?

Në një rreth ku komunikimi zhvillohet duke përdorur një të folur e cila bën pjesë në një prej dialekteve ose në dialekte të shqipes , e cila nuk është gjuha e standardizuar , siç janë shprehur mësime të qytetit të Istogut në një prej anketimeve- se e shohin të folurën e vendit si një nga pengesat e mëdha , duhet të aktivizohen të gjithë pjesëtarët e shoqërisë për ta përmirësuar këtë aspekt, por mësime të kursesi nuk duhet të bëjnë këtë gabim, sepse *gjuha standarde nëpërmjet sistemit arsimor, kontribon në menjanimin e dallimeve dialektore.*⁴¹

Arsyet e mospërdorimit të gjuhës standarde mund të themi se janë shumë të lidhur, për të mos thënë të njëjtë, me ato në të cilat kemi hasur në shkollën fillore. Por dallimi i gjimnazit me shkollën fillore qëndron në faktin se nxënësit e gjimnazit tashmë kanë arritur në një moshë ku gjërat i kuptojnë më ndryshe nga nxënësit e shkollës fillore, bëjnë dallimin mes gjuhës standarde dhe dialektit , dhe shumë gjëra tjera tashmë i kanë mësuar, por përdorimin e gjuhës standarde dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe ende nuk kanë arritur t’a përvetësojnë në nivel të kënaqshëm, shprehen mësime të.

⁴¹ Ibrahim, Mustafa , “Trajtesa leksioko-frazeologjike të shqipes”, Shkup, 2015”, f.12

Në qoftë se shumica e këtyre nxënësve nuk kanë arritur që t'i zotojnë rregullat bazë të gjuhës standarde në shkollimin e deritanishëm, sic e kemi rastin tek nxënësit e gjimnazit "Haxhi Zeka", atëherë faji nuk bie mbi kurrizin e nxënësve, por të mësimdhënësve.

Në një libër të tij, J. Rexhepgjiqi është shprehur se *"cdo arsimtar duhet të jetë i frymëzuar me besimin në të ardhme më të mire. Idealin e vet jetësor, hovin dhe aftësinë e tij arsimtari nuk mund të mos e përqendrojë te të tjerët, në rradhë të pare, në gjeneratat e reja. Në esencën e etikës profesionale të arsimtarit është që të jetë i kujdesshëm, i interesuar dhe i vendosur në punë dhe t'i nxisë vlerat etike e vlerat e tjera, idetë e reja dhe qëllimet progresive të shoqërisë."*⁴²

Edhe pse tashmë këta nxënës do të duhej të "hyjnë" më thellë në shkencën e gjuhësisë (por edhe të shkencave tjera, të cilat nuk do t'i kishin kuptuar tërësisht pa e njohur gjuhën standarde), ka ende vend për t'i përmirësuar shprehitë e të folurit dhe të shkruarit në gjuhën standarde, por kjo do të bëhej e arritshme vetëm nëse mësimdhënësit me këmbëngulje dhe me zotim të duhur të gjuhës standarde, i transmetojnë njohuritë e tyre tek nxënësit. Në vijim mund t'i shohim rezultatet nga pyetësorët të cilët i kemi realizuar në gjimnazin "Haxhi Zeka".

⁴² Rexhepagiq, Jashar, "Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike", Prishtinë, 2002, f.361

6. Paraqitja statistikore e rezultateve nga pyetësi i bërë në gjimnazin “Haxhi Zeka”


Gjimnazi “Haxhi Zeka” duke ditur se është institucion parauniversitar, duhet t’l kushtojë më shumë vëmendje nxënësve në drejtime të ndryshme. Nga ana psikologjike e dime se ata janë në një moshë shumë delikate, në një periudhë ku ndërtojnë karakterin e tyre i cili do jetë shoqëruesi i tyre i pandanshëm në jetë. Në këtë periudhë zgjedhin preferencat e tyre për drejtimin profesional për të cilin më vonë do t’l ndjekin studimet.

Por , pavarësisht se çfarë do të zgjedhin të bëjnë nxënësit e sotëm të gjimnazit, qoftë ajo studime apo punë , përdorimi i gjuhës standarde nuk do të jetë në dëm të atyre në asnjë rast, sepse , *gjuha është l vetmi institucion shoqëror pa të cilën asnjë institucion tjetër nuk mund të funksionojë*⁴³ , dhe zotimi e përdorimi i gjuhës standarde shqipe do të jetë në dobi të tyre, duke l ndihmuar ata të komunikojnë pa barriera. Në gjimnaz, sikurse edhe në shkollën fillore në Istog, kemi bërë një varg pyetësorësh dhe anketash , rezltatët e të cilëve do t’l shohim në vijim. 51 prej mësimdhënësve kanë dhënë përgjigjet e tyre me shkrim në pyetësorët e realizuar.

27 prej tyre kanë dashur që të mbesin anonim, 19 kanë shkruar vetëm inicialet e emrit dhe mbiemrit, ndërsa 5 kanë shkruar emrin dhe mbiemrin e plotë. Në pyetjen e pare , e cila ka qenë *“A mendoni se në shkollën tuaj gjuha standarde shqipe përdoret mjaftushëm?”* , 7 mësimdhënës janë përgjigjur me *PO* (vetëm 14%) , kurse një numër l konsiderueshëm e tyre prej 44 me *JO* (86% e mësimdhënësve).


⁴³ Ibrahim, Mustafa , “Gjuhë dhe kulturë”, Shkup, 2016, f.20

1.A mendoni se në shkollën tuaj gjuha standarde shqipe përdoret mjaftueshëm?




Pyetja e dytë , e cila ka qenë “A ndihmojnë mediat dhe rrjetet sociale në përvetësimin e gjuhës standarde?” , dhe 31 mësimdhënës ,ose 61 % janë shprehur se PO, mediat dhe rrjetet sociale ndihmojnë në përvetësimin e gjuhës standarde, ndërsa 20 (ose 39 %) kanë thënë se JO, mediat nuk ndihmojnë aspak në këtë çështje.

2.A ndihmojnë mediat dhe rrjetet sociale në përvetësimin e gjuhës standarde?




Pyetja tjetër, “A ndikojnë rrjetet sociale në moslexim tek nxënësit?”, 29 (57 %) mësimdhënës kanë thënë PO, ndërsa 22 mësimdhënës (ose 43%) JO.




Duke ditur se nxënësit e gjimnazit janë në moshë kur tashmë i kanë përvetësuar disa nga gjuhët e huaja të cilat i mësojnë në shkollë dhe komunikojnë me të edhe jashtë shkollës, p.sh. gjuha angleze e cila është bërë gjuhë globale në të gjithë botën, edhe njerëzit gjithnjë edhe më shumë e përdorin në jetën e përditshme ,për këtë çështje është parashtruar pyetja “Sa ndikojnë gjuhët e huaj , p.sh. gjuha angleze , në mospërdorimin e termave shqip?” , ku 32 (ose 63%) kanë thënë se gjuhët e huaja ndikojnë shumë në mospërdorimin e termave shqipe tek nxënësit , 12 mësimdhënës (ose 23%) thonë se ndikimi i gjuhëve të huaj është i vogël, dhe 7 (ose 14%) thonë se gjuhët e huaj nuk kanë aspak ndikim.

4. Sa ndikojnë gjuhët e huaj , p.sh. gjuha angleze , në mospërdorimin e termave shqip?”




Pyetjes së rradhës , “Në cilin dialekt bazohet gjuha standarde shqipe?”, 45 mësimdhënës (88 %) janë përgjigjur me *toskërisht*, 4 mësimdhënës (ose 8%) kanë thënë se gjuha standarde shqipe bazohet në dialektin *gegë* dhe 2 mësimdhënës (4 %) mendojnë se gjuha standarde shqipe bazohet në të *dy dialektet*.

5. Në cilin dialekt bazohet gjuha standarde shqipe?




Përafërsisht gjysma e mësimeve ose 28 mësimeve (55%) kanë rumbullakësuar opsionin *a) të folurën e vendit*, dhe 23 prej tyre (ose 45%), *b) gjuhën e njësuar shqipe*, pyetjes: “Gjatë komunikimit me nxënësit, ju përdorni gjuhën shqipe të njësuar apo të folurën e vendit?”



Prej 51 mësimeve, përgjigjen në pyetjen “Në çfarë mënyrë mund të përmirësohet të folurit në gjuhën standarde shqipe?”, 14 mësimeve (27%) mendojnë se: *a) me lexim të vazhdueshëm*, 10 (20%) *b) me komunikim*, dhe *c) me të dyja*, kanë dhënë përgjigje 27 mësimeve (53%).

7. Në çfarë mënyrë mund të përmirësohet të folurit në gjuhën standarde shqipe?



Në bisedë me mësuesit, e cila ka qenë pjesë e anketimit, njësoj sikur në shkollën fillore “Bajram Curri” poashtu edhe në gjimnazin “Haxhi Zeka”, kemi shënuar fjalët të cilët nuk janë të gjuhës së standardizuar por të folurit të Istogut, të cilët përdoren shpesh. 34 nga 51 mësuesit e përdorin fjalën *qysh*, dhe vetëm 17 fjalën *si*. 20 mësuesit thonë *t’a bëni*, dhe 31 *me i ba*. Në vend të fjalës *shikoje*, 29 prej 51 mësuesit në hapësirat edukativo-arsimor në komunikim me kolegët dhe nxënësit e përdorin *kqyre*.

Fjalët *i jemi/i tina* në vend të formës *i imi/i atij*, e kanë përdorur 29 mësuesit. Poashtu, *asajna/atina* në vend të *asaj/atij* e kemi dëgjuar nga 27 mësuesit.

Kemi mbledhur bashkë nga përgjigjet e dy shkollave të cilët kanë marr pjesë në hulumtim fjalët sinonime të cilët shpesh herë mësimdhënësit i përdorin në të folurin e vendit. Disa prej tyre janë fjalët mundem, ndihmoj, arrij, dëgjoj, mbaron, shëndosh, shkrirë, afër, hapur.

Sinonim i fjalës *mundem* në jetën e përditshme të mësimdhënësve janë fjalët : *muj, munem, muna, munda, munim, mundi*. *Ndihmoj*, mësimdhënësit e përdorin në formën *nimoj dhe ndimoj*. Në vend që të jetë *arrij*, përdoret : *mrrij, mrrri, vi, mbrrij, mberri, jom ardh*. Për *degjoj*, përdoren fjalët : *nigoj, ni, ndi, vezhgoj, ndegjoj, nij, ndij*.

Mbaron përdoret edhe : *u kry, u sos, kryet, maron, shëndosh* përdoret edhe *sh'nosh*. Fjala *afër* zëvendësohet me *ngat ose n'at, shkrirë* me fjalët : *çkrit, çkrime, çrime, çkrir, shkrim, shkrit*. Dhe fjala *hapur*, më së shpeshti përdoret si : *çelur, çel, çelun, hapun, hapne, hapme, hapt*.

III. Kapitulli i tretë

1. Vështrim krahasues të rezultateve nga dy shkollat

Në kapitullin e dytë të këtij punimi jemi njoftuar me shkollën fillore dhe gjimnazin , dhe kemi parë rezultatet nga pyetësorët , të cilët janë plotësuar nga ana e mësimitdhënësve të dy shkollave, lidhur me përdorimin e gjuhës standarde. Në vijim do t'i krahasojmë përqindjet e të dy shkollave.

Në shkollën fillore “Bajram Curri” , 35 % e mësimitdhënësve mendojnë se gjuha standarde përdoret mjaftueshëm, që është numër më i madh sesa në gjimnaz, ku vetëm 14% e mësimitdhënësve janë përgjigjur pozitivisht.

Në lidhje me pyetjen e dytë, a ndihmojnë mediat sociale në përvetësimin e gjuhës standarde kemi përqindje të përafërt, të shkollës fillore 56% dhe të gjimnazit 61% mësimitdhënës mendojnë se mediat ndihmojnë në këtë drejtim.

Ndërkohë, në lidhje me mediat sociale dhe ndikimi i tyre në moslexim tek nxënësit, me përgjigje pozitive kemi 90% të mësimitdhënësve të shkollës fillore dhe 57% të gjimnazit. Ky numër i madh mësimitdhënësish të cilët e shohin përdorimin e mediave sociale si pengesë në leximin e librave tek nxënësit në një shkollë fillore, dhe të cilët janë të moshës shumë të re (nga 5-6 vjec deri 14-15 vjec) , tregon se në këtë aspekt duhet të punohet më shumë nga e gjithë shoqëria, duke filluar nga familja , e cila është shtylla kryesore, pastaj mësimitdhënësit , të cilët kalojnë një pjesë të ditës me nxënësit. T'iu japim shembull pozitiv fëmijëve tanë, sepse , siç thotë një thënjë e vjetër : *fëmijët nuk dëgjojnë këshillën tonë , por ndjekin shembullin që ua japim ne .*

Për pyetjen e rradhës, sa ndikojnë gjuhët e huaja në mospërdorimin e termave shqipe, kemi marr përgjigjet: *shumë* – 46% të mësimitdhënësve të shkollës fillore dhe 63% të gjimnazit; *pak* – 48% të mësimitdhënësve në shkollën fillore dhe 23% të gjimnazit, dhe me përgjigjen *aspak* në të dy shkollat kemi një numër të vogël mësimitdhënësish (në shkollën fillore 6% dhe në gjimnazin 14%), që tregon se mësimitdhënësit e vërejnë këtë dukuri tek nxënësit, sidomos të përdorimit të termave të gjuhës angleze , e cila jo vetëm tek ne , por në të gjithë botën ka filluar të bëhet gjuhë globale, pasi që jemi të ndikuar prej saj gjatë gjithë kohës, qoftë duke përdorur teknologjinë , dëgjuar lajmet e botës, për komunikim global është gjuha më univërzale, të cilën e njohin shumë njerëz në botë.

Gjuha e sotme letrare ose standarde bazohet në dialektin tosk, dhe këtë përgjigje e kanë dhënë 59% të mësimitdhënësve të shkollës fillore dhe 88% të shkollës së mesme. Një numër e vogël mendojnë se ajo bazohet në dialektin gegë (6% të mësimitdhënësve të cilat kanë plotësuar pyetësorët në shkollën fillore dhe 8% të gjimnazit), ndërsa përqindja e mësimitdhënësve të cilët mendojnë se gjuha letrare ose standarde bazohet në të dy dialektet është 35% nga shkolla fillore dhe 4 % të gjimnazit.

Për t'a përmirësuar të folurin dhe zotimin e gjuhës letrare më shumë , 19% të mësimitdhënësve të shkollës fillore dhe 27% të gjimnazit mendojnë se do të kishte ndihmuar leximi, 14% të shkollës fillore dhe 20 % të së mesmes thonë se me komunikim, ndërsa 67% (nga shkolla fillore) dhe 53% (nga gjimnazi) janë përgjigjur se me ndihmën e të dyjave – lexim dhe komunikim do të mund të arrihet të përvetësohet gjuha standarde në nivel më të lartë.

2. Rekomandimet nga mësime dhënësit e shkollave të Istogut në lidhje me mospërdorimin e gjuhës standarde shqipe

Mësime dhënësit të të dy shkollave , përvec përgjigjeve të pyetësorit me përgjigje të shkurtër (po/jo, pak/ shumë, etj.) , iu janë parashtruar pyetje të cilat kanë kërkuar një përgjigje më të zgjëruar, kuptohet , përgjigjet e tyre kanë qenë opsionale. Nga të dy shkollat, nga gjithsej 103 mësime dhënësit të cilat kanë marr pjesë me përgjigjet e tyre në këtë pyetësor, për këtë pyetje (*Sipas mendimit tuaj, cfarë rekomandimi do të kishit për mësime dhënësit të cilët nuk e përdorin mjaftueshëm gjuhën standarde në mjedisin shkollor?*) kemi marr 36 përgjigje ose mendime nga ata, në formë të shkruar. Rekomandimet nga këta mësime dhënësit do t'i citojmë në vijim:

1. *“ Të lexojmë dhe të komunikojmë në gjuhën letrare. ”*
2. *“ Të bëjmë përpjekje që ta përdorim gjuhën standarde ”*
3. *“ Do ju rekomandoja që për të mirën e nxënësve ta përdorin sa ma shumë gjuhën letrare.”*
4. *“ Ato që nuk e përdorin duet dënuar apo bile kritikuar .”*
5. *“ Të përdoret gjuha standarde gjithkund , sidomos në shkolla. ”*
6. *“ Të mundohem sa ma shumë ta përdorim atë, kështu do unifikohet gjuha. ”*
7. *“ Rekomandoj që të gjith mësime dhënësit ta përdorin gjuhën letrare. ”*
8. *“ Përdor nga cdo mësime dhënësit ”*
9. *“ Duhet të lexojm shumë ma shumë. ”*
10. *“ U kisha preferu ta përdorin gjuhën standarde shqipe ”*
11. *“ Ndjekni kurset e komunikimit me nxënës në rradhë të pare. ”*
12. *“ të lexojm sa ma shumë, ti mësojm rregullat e drejshkrimit dhe gjuhën letrare ”*

13. *“ Në një shkollë patjetër duhet përdorur gjuha standarde nga gjithë mësuesit dhe aktorët tjerë brenda shkollës. ”*
14. *“ Që ta përdorim gjuhën letrare të nisuar ”*
15. *“ Të jemi më të përgjegjshëm për mënyrën e komunikimit me nxënësit. ”*
16. *“ I kisha rekomanduar mësuesit që edhe nxënësit ta përvetsojnë nga mësuesit. ”*
17. *“ Duhet ta përmirsojmë fjalorin. ”*
18. *“ Mësuesit që ligjerojnë, gjatë procesit mësimor sa më shumë ta përdorin gjuhën standarde. ”*
19. *“ Nëse të gjithë mësuesit përdorin gjuhën letrare atëherë do të kemi nxënësit me fjalor më të rrjedhshëm dhe gjuhësia sa më e mirë. ”*
20. *“ Do të ishte mirë të përdoret shqipja. ”*
21. *“ Unë do t’ju rekomandoja ta përdorin gjuhën standarde jo vetëm në shkollë, por çdo here e çdo kund! ”*
22. *“ Secili mësues ta përdor me qellim që të përvetsojë nxënësit. ”*
23. *“ Të përdoret përveç në komunikim edhe në drejshkrim, për të formuar shprehje të qëndrueshme tek nxënësit. ”*
24. *“ Nxënësit e marrin shembullin nga ne mësuesit prandaj ne duhet ta përdorim gjuhën standarde. ”*
25. *“ Të përdoret gjuha standarde dhe për ndonjë nxënësit që nuk e kupton ndonjë fjalë apo term t’i japim sqarim. ”*
26. *“ Mendoj se secili mësues duhet ta përdor gjuhën që është e kuptueshme për nxënësit, nuk është patjetër ta përdorim gjuhën standarde. ”*
27. *“ Gjuha standarde të zbatohet urgjent, të bëhet ligj! Të merren masa për ata që nuk e përdorin gjuhën standarde në shkollë. ”*
28. *“ T’i udhëzojmë nxënësit edhe kolegët, të lexojmë më shumë. ”*
29. *“ Nuk e përdorim gjuhën e nënës se edhe te shpirtëria I thojna nënës e jo nënës. ”*
30. *“ Lexim më të madh dhe shpirtëria I dokumentarëve shqip. ”*

31. *“ Me nxënësit duhet përdorë gjuha standarde,me tjerët jo.”*
32. *“ Duhet të jetë I domosdoshëm përdorimi I gjuhës standarde, por mësimdhënësit janë për keqardhje, skemi qka bëjmë në këtë aspekt.”*
33. *“ Përdorimi I gjuhës shqipe standarde në shkolla është në nivel alarmant ”*
34. *“ Me lexu sa ma shum,me fol drejt me nxënës.”*
35. *“ Nëse mësimdhënësit nuk e zotojnë gjuhën standarde të ndjekin kurse për përvetësim”*
36. *“ Është gabim I madh I tyre! Duhet shprehur me gjuhën standarde për hir të nxënësve.”*

Kjo pyetje, përvecse ka patur qëllim që t’i shohim mendimet e mësimdhënësve lidhur me mospërdorimin e gjuhës standarde dhe rekomandimet e tyre , është parashtruar edhe me qëllim që të shohim një pjesë shumë e rëndësishme tek mësimdhënësit- drejtshkrimi I tyre dhe respektimi I rregullave drejtëshkrimore . Një varg mungesash vërehen në fjalitë më lart, duke filluar me mungesë të shenjave të pikësimit, fillim I fjalisë me shkronjë të vogël, paqartësi në të shprehurit, etj. , gjëra të cilat do t’l përpunojmë më hollësisht në vijim.

3. Gabimet drejtshkrimore të mësimdhënësve

Hegeli thotë se “*edukatori duhet të jetë edhe vetë i edukuar*”⁴⁴, edukatori ose mësimdhënësi në rradhë të pare duhet vetë t’i zotojë mire dhe t’i respektojë rregullat e drejtshkrimit të fjalëve, në mënyrë që t’i përcojë tek nxënësit në formën e saktë, sepse *pa një drejtshkrim të njësuar nuk mund të ketë një gjuhë të përbashkët letrare*⁴⁵. Pasi që kemi parë rekomandimet nga mësimdhënësit në formë të shkruar, mund të themi se shpesh herë këto rregulla për të cilët flasim nuk respektohen.

Shenjat e pikësimit përdorën në të shkruar për ta bërë më të qartë e më të kuptueshme përmbajtjen e një thënie. Pikësimi, krahas alfabetit dhe drejtshkrimit, përbën një nga tri nënsistemet e gjuhës së shkruar .⁴⁶ Pika, si një nga shenjat kryesore të pikësimit, përdoret në fund të një fjalie dëftore të pavarur .⁴⁷ Në rekomandimet nga mësimdhënësit e shkollave në Istog, mund të shohim mospërdorimin e pikës në fund të rekomandimit të 2, 8, 10, 12, 14, 33 dhe 35. Tjetër mangësi në të shkruarit të mësimdhënësve është mospërdorimi i ë-jës fundore. Këtë gabim e shohim te këto rekomandime:

-rekomandimi I 7: *të gjith* në vend se të jetë *të gjithë* ;

-rekomandimi I 9: *të lexojm* në vend të : *të lexojmë* ;

-rekomandimi I 12: *të lexojm* dhe *të mësojm* në vend të: *të lexojmë* dhe *të mësojmë* ;

- rekomandimi I 19: të gjith në vend të : të gjithë ;

-rekomandimi I 22: *të përvetsojn* në vend të : *të përvetësojnë* (këtu mungojnë 2 ë-ja) ;

⁴⁴ Hegel, G.V.Fridrih, “Djalektika, logicka nauka”, Beograd, 1939, f.790

⁴⁵ Kadriu, Zeqir, “Norma e gjuhës standarde shqipe”, Tetovë, 2007, f.17

⁴⁶ Ibid, f.105

⁴⁷ Ibid, f. 108

Fjala *mësimdhënës* poashtu është shkruar me mungesë të zanores ë, në rekomandimin e 7 është shkruar *mësimdhënsit* (me mungesë të dy ë-ja – *mësimdhënësit*), në rekomandimin e 8 – *mësimdhëns* (*mësimdhënës*) dhe në rekomandimin e 13 - *mësimdhënsit* (gjithashtu pa një ë – *mësimdhënësit*). Zëvendësim i zanores ë me a , më së shpeshti e vërejmë kur përdoret në formën krahasuese *më shumë* . Te rekomandimi i 3, 6, 9, 12 dhe 34 është përdorur *ma shumë* në vend që të jetë *më shumë* . Gabime tjera drejtshkrimore shohim edhe në fjalitë në vijim, pas të cilave do ta paraqesim formën e saktë të fjalëve:

- 4: *duet dënuar apo bile kritikuar* → *duhet dënuar apo të paktën kritikuar* ;
- 6: *Të mundohem* → *Të mundohemi* (shumësi i fjalës *mundohem* , pasi që bëhet fjalë për më shumë mësimdhënës);
- 8: *Përdor* → *Të përdoret* ;
- 10: *U kisha preferu* → *Do t'iu kisha preferuar / propozuar* ;
- 13: *aktorët e tjerë brenda shkollës* → *pjesëtarët e tjerë të stafit në shkollë* ;
- 14: *të nisuar* → *të njësuar* ;
- 16: *I kisha rekomanduar mësimdhënësit* → *Iu kisha rekomanduar mësimdhënësve* ;
- 29: *te shpija I thojna nanë e jo nënë* → *në shtëpi I themi “nanë” e jo “nënë”* ;
- 30: *Lexim më të madh dhe shiqim I dokumentarëve shqip* → *Të lexojmë sa më shumë dhe të shikojmë dokumentar shqip* ;
- 31: *përdorë* → *përdorur* ;
- 32: *qka bëjmë* → *çfarë të bëjmë* .

Kemi edhe një përgjigje e cila është komplet jashtë standardit, dmth e shkruar në dialektin gegë. Ajo është e 34, “ *Me lexu sa ma shum, me fol drejt me nxënës.*”, e cila po të ishte shkruar duke respektuar rregullat drejtshkrimore dhe duke përdorur gjuhën standarde do të ishte : “*Të lexojmë sa më shumë , të flasim drejtë me nxënësit.*” Kurse, në rekomandimin e 12 , kemi hasur në një gabim shumë të madh – fillimi I fjalisë me shkronjë të vogël. Gabimet e këtilla nuk duhet toleruar , të paktën jo kur bëhen nga ana e mësimitdhënësve . Por, në këtë hulumtim , shohim edhe fjali të llojit : “*Do ishte mire të përdoret shqipja*” , ndërkohë që , në të gjithë pyetëtorin është përmendur se bëhet fjalë për gjuhën shqipe. E kuptojmë që mësimitdhënësi ka dashur të thotë “*Do ishte mire të përdoret shqipja letrare*”, por në mungesë të një fjale, e tërë fjalia merr kuptim tjetër.

Dhe , pyetja e fundit të cilën e kemi parashtuar lidhur me këtë hulumtim, kanë qenë fjalët e Dritëro Agollit :

“Në vendin tim e në vendin tend,

Një kokë e cmendur – një vend e cmend”

Kemi kërkuar nga mësimitdhënësit t’i shpjegojnë vargjet e Agollit, për të cilët kemi marr përgjigje me shkrim nga 28 mësimitdhënës, të cilët do t’i citojmë dhe krahas tyre do të shkruajmë ku janë bërë gabimet drejtshkrimore, pa e ndryshuar kuptimin e fjalive.

1. “*Një mendje e shëndosh do të afronte një shtet me jet të mire*”

- Një mendje e shëndoshë do të ofronte një shtet me jetë të mire.

2. “*Një udhëheqës I keq e len mbrapa një popull*”

3. “*Për një kokë të mencur vendi mund të shkoj përpara.*”

- Falë një koke të mencur, vendi mund të shkojë përpara.

4."Do të thot me kënd rrim,bëhemi si ata."

-Do të thotë me kë rrimë, bëhemi si ata.

5."Gjeneratat që dalin nga një mësues I keq, s'kanë si të dalin ndryshe. "

6."Ky mendim asimilon rinin dhe shoqerin."

- Ky mendim asimilon rininë dhe shoqërinë.

7."Nëse një mësimmhdhënës nuk është I formuar si duhet, askush nuk ja sheh hajrin po sherrin."

- Nëse një mësimmhdhënës nuk është I formuar si duhet, askush nuk ia sheh hajrin,
po sherrin.

8."Dritëro Agolli ka sugjeru që në vendin tim e në vendin tend të mbizotroj koka e arsyes."

- Dritëro Agolli ka sugjeruar që në vendin tim e në vendin tend të mbizotrojë
koka e arsyes.

9."Agolli,një kokë e ndritur atëherë u shpreh për politikanët tone"

10."Realiteti I hidhur që mbizotron."

- Realiteti I hidhur që mbizotëron.

11."Veprimet e pamatur nga udhëheqësi I shtetit sjellin pasoja të mëvonshme."

12."Një moll e kalbt mes mollave të shëndosh I kalb tjerët."

- Një mollë e kalbur mes mollave të shëndoshë, I kalb tjerët.

13."Një udhëheqës I mire - një vend I suksesshëm."

14."Shkrimtari ka dasht të thot se duhet qdo kund të veproshe me menquri."

- Shkrimtari ka dashur të thotë se duhet gjithkund të veproshe me mencuri.

15. "Gjithmonë duhet të ndjekim hapat e atij që është I mencur."

16. "Shkrimtari ka pas të drejtë sepse sot përballem me libra të përpiluar nga njerëz jo të duhur, me shumë gabime drejshkrimore."

- Shkrimtari ka patur të drejtë, sepse sot përballemi me libra të përpiluar nga njerëz jo të duhur, me shumë gabime drejtshkrimore.

17. "Me e derqadue qeqnishten!"

- Të degradohet gegërishtja!

18. "Rëndësia e udhëheqësit qendron në faktin se ai ndihmon ose dëmton krejt popullin."

19. "Udhëheqësi jo I duhur corienton një shoqëri të tërë."

20. "Në këto vargje shoh tentim për të dominuar toskërishtja dhe me c'vlersu qeqnishten ton të mire."

- Në këto vargje shoh tentim për të dominuar toskërishtja dhe të c'vlerësohet gegërishtja jonë e mire.

21. "Një person që ka përgjithësi duhet të ketë kujdes për veprimet dhe fjalët, të mos ketë pasoja."

22. "Ka kuptimin ashtu si është udhheqësi do jen tjerët pas tij"

- Ka kuptimin ashtu sic është udhëheqësi, do të jenë të tjerët pas tij.

23. "Atdheu është në rrezik atëherë kur e udhëheqin njerëz të padijshëm që mendojnë se janë të gjithëdijshëm."

24. "Të dallojmë fjalët e një njeriu të mencur nga fjalët e një koke të cmendur"

25. "Është e njejta me thënien "një mollë e kalbur e kalb qjith shportën"."

- Është e njejta me thënien "një mollë e kalbur, e kalb të gjithë shportën".

26. "Gjuha e keqe sjell shumë të këqija."

27. "D.Agolli ky e bën krahasimin e popullit shqiptar, se ne të gjith jemi njësoj."

- D.Agolli, ky shkrimtar , e bën krahasimin e popullit shqiptar, se ne të gjithë jemi njësoj.

28. "Poeti shpreh shqetsimin për gjithë popullin shqiptar në të gjitha trojet."

Dhe, në fund, sic është shprehur një mësime dhënë nëpërmjet këtij pyetësi, shkrimtari jonë I njohur Dritëro Agolli shpreh shqetësimin për të gjithë popullin shqiptar, duhet edhe ne, populli, mësime dhënësit dhe të gjithë shqipëtarët , pavarësisht nga cila pjesë vijnë, të shqetësohemi për të ardhmen e popullit tonë, të punojmë më shumë që të ndërtojmë një sistem arsimor më kualitativ, sepse vetëm nëpërmjet arsimimit një popull shkon përpara.

IV. Kapitulli I katërt

1.Përfundimi

Në këtë hulumtim, të titulluar “Përdorimi I gjuhës standarde shqipe në shkollën fillore dhe të mesme në Istog”, kemi patur për qëllim që të analizojmë shkallën e përdorimit të gjuhës standarde shqipe nga ana e mësimitdhënësve në komunikim me nxënësit, sa nxënësit e kuptojnë gjuhën standarde e cila do të duhej patjetër të përdoret në të gjitha institucionet arsimore, sa është prezente e folura e vendit dhe sa shpesh mësimitdhënësit I ikin normës letrare në komunikim të drejtpërdrejtë dhe drejtshkrimi ose gabimet drejtshkrimore të cilat I kemi analizuar, duke patur materijal nga vetë shkrimi I mësimitdhënësve.

Për shkallën e përdorimit të gjuhës standarde e kemi kuptuar që nuk është në nivel sic do të duhej të ishte , këtë e kanë komfirmuar edhe vetë mësimitdhënësit nëpërmjet komunkimit-gjatë anketimeve dhe përgjigjet me shkrim, ku edhe ata vetë mendojnë se në këto institucione gjuha standarde nuk përdoret mjaftueshëm.

Kemi ardhur në përfundim se cdo mësimitdhënës do të kishte dashur që të bëjë më të mirën nga vetja në këtë aspect shumë me rëndësi, por si duket janë shumë faktorë tjerë të cilët kanë ndikim të madh I cili e pengon përdorimin e gjuhës standarde. Njëri prej faktorëve kryesor është rrethi ku jetojmë – mësimitdhënësit janë shprehur se një pengesë shumë e madhe është që , kur komunikojnë me nxënësit duke përdorur gjuhën standarde, hasin në vështirësi të të kuptuarit nga ana e nxënësve dhe ata e ndiejnë vetën të obliguar t’iu japin shpjegim për gjërat e paqarta në të folurën e vendit, me të cilin janë mësuar nxënësit. Poashtu edhe familjarët e nxënësve e kërkojnë një gjë të tillë gjatë takimeve me mësimitdhënësit, pa I përmendur edhe vetë mësimitdhënësit , të cilët , sic duket, bëjnë një veprim të pahijshëm , me të cilin tallin kolegët mësimitdhënës të cilët po komunikojnë duke përdorur gjuhën standarde.

Ky është veprim i cili nuk duhet përsëritur , sepse nga gjërat në dukje të vogla (sikur ky veprim) , vjen deri te krijimi I një shoqërie e cila nuk zoton gjuhën e vet, standardin e gjuhës së vet bashkë me drejtëshkrimin e drejtshqiptimin e fjalëve. Këto janë gjëra të cilat janë të lidhur mes vete. Mësimdhënësit e sotëm, kanë qenë nxënës dikur, dhe gjatë asaj periudhe të fillimeve të arsimimit , nuk kanë arritur që t'f itojnë disa parime bazë, ndoshta shkaku I të cilëve edhe sot e kësaj dite hasim në gabime shumë të rënda gjuhësore sa I përket drejtshkrimit. Ky nuk është shkrim dosido, por shkrimi I një mësimdhënësi , të cilin shumë gjenerata e përcjellin dhe e marrin shembullin e tij. Porosia jonë për cdo mësimdhënësi është që , të mundohemi të bëjmë më të mirën nga vetja në aspektin arsimor në përgjithësi, dhe në përdorimin e gjuhës standarde në vecanti, të lexojmë sa më shumë , t'f mësojmë gjeneratat e reja të lexojnë dhe të ndërtohen si persona të edukuar dhe të arsimuar, nëse duam një të ardhme më të mire me kuadra me vlera dhe dituri , me të cilët do të krenohemi që janë pjesë e popullit tone .

3. Bibliografia

1. Arkivi i gjimnazit "Haxhi Zeka", Istog
2. Arkivi i shkollës fillore "Bajram Curri", Istog
3. Çabej, Eqrem , *"Sudime gjuhësore"* , Pishtinë , 1975
4. Demiraj, Shaban , *"Historia e gjuhës së shkruar shqipe"*, Tiranë , 1967
5. Dodi , Anastas , *"Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe"* , Tiranë , 2004
6. Fjalori I gjuhës shqipe, Tiranë , 1954
7. Gashi, Sejdi, *"Areali gjuhësor I Istogut me rrethinë "* , Disertacioni i doktoraturës , Tetovë, 2018
8. Gjinari , Jorgji , & Shkurtaj, Gjovalin, *"Dialektologjia"*, Tiranë, 2003
9. Ibrahimimi , Mustafa, *"Gjuhë dhe kulturë "* , Shkup, 2016
10. Ibrahimimi, Mustafa , *"Trajtesa leksioko-frazeologjike të shqipes"*, Shkup, 2015
11. Kadriu, Zeqir, & Latifi, Lindita , *"Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe"*, Tetovë, 2008
12. Kadriu , Zeqir, *"Norma e gjuhës standarde shqipe"* , Tetovë, 2007
13. Komuna e Istogut , *"Plani lokal I veprimit në mjedis, 2012/2017"* , 2012
14. Komuna e Istogut , *" Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017/2021"*, 2017
15. Mehmetaj, Haxhi, *"Trashëgimia arkeologjike e komunës së Istogut"* ,Prishtinë , 2016
16. Osmani, Jusuf, *"Vendbanimet e Kosovës – Burimi (Istogu)"*, Prishtinë, 2004
17. *"Planprogrami zhvillimor dhe mësimor I shkollës fillore "Bajram Curri" për vitin shkollor 2018/19"* , Istog, 2019
18. *"Planprogrami mësimor I gjimnazit "Haxhi Zeka " viti 2018/19"* Istog, 2019
19. Rexhepagiq, Jashar, *"Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike"*, Prishtinë, 2002
20. Shkurtaj Gjovalin, *"Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe"*, Tiranë , 2003
21. [wikipedia.org/wiki/Shp%C3%ABr%20ndarja_e_shqiptar%C3%ABve#cite_note-1](https://www.wikipedia.org/wiki/Shp%C3%ABr%20ndarja_e_shqiptar%C3%ABve#cite_note-1)
22. <https://kk.rks-gov.net/istog/drejtore/drejtoria-e-arsimit/>

V È R T E T I M

Kandidatja për shkallën master në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Nexhiba Ramadani, dorëzoi për redaktim gjuhësor (lekturim) tezën Master me titull: “ **Përdorimi i gjuhës standarde shqipe në shkollat fillore dhe të mesme në Istogut**”, udhëhequr nga mentori Prof.Dr.Zeqir Kadriu.

Pas redaktimit gjuhësor (lekturimit) vërtetohet se e njëjta i plotëson kriteret gjuhësore e drejtshkrimore të gjuhës së sotme standarde shqipe dhe mund të shkojë në procedurë të mëtutjeshme.

Shkup, janar. 2020

Prof.Dr. Xhemaludin Idrizi